



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MULI Y. MALLKUÇI
ADRESA NR.5, VASO PASHA, NR.13/1
TEL: 692020292

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 1230

Nr. koleksioni: 593

Tirane më 23/09/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2024050370069627509



A2024050370069627509

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot, më datë 23.09.2024, para meje Noter MULI Y. MALLKUÇI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, VASO PASHA, NR.13/1, u paraqit personalisht:

SHITES:

Shoqeria NAVY YARD CAPITAL LLC, regjistruar si organizate biznesi ne shtetin Delaware (USA) me adresen qendrore 1111 New Jersey Avenue SE 524, Washington DC, 20007, USA, përfaqësuar nga **Z. Eno Kotmilo**, shtetas Amerikan, i biri i Gjergj, lindur në Tirane, më 13.08.1981, i identifikuar përmes Pasaportës Amerikane me nr. 505478330, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e më poshtë referuar si: "Shitësi"),

BLERES:

Shoqëria PRIME CAPITAL SHPK, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit K92107012P, me adresë Km 10 Tirane-Elbasan, pranë Restorant ALPIAG Mullet, përfaqësuar nga z. Ilir Bejleri, atësia Genci, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tirane, me adresë Blv. B. Curri, Pall. Agimi, Shk. 7/1A, Tirane, lindur më 05.04.1978, gjendja civile "martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte nr. BJ4505367 dhe nr. personal H80405248D.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë NoterI konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të aksioneve të "**Rubicon**" SH.A, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Baza Ligjore:

- Neni 705 e në vijim i Kodit Civil;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar;
- Statuti i shoqërisë "Rubicon" SH.A;
- Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë "Rubicon" SH.A nr. 72/1, datë 08/12/2023;
- Njoftimi i transferimit të bashkëaksionerëve të shoqërisë "Rubicon" SH.A.

Neni 1 - Objekti i Kontratës

Objekti i Kontratës është Shitje e aksioneve të zotëruara në shoqërinë "RUBICON" SH.A, me NIPT M02129014T.

1. Shitësi, NAVY YARD CAPITAL LLC, është zotërues i 3100061.0000 (tre milion e njeqindmije e gjashtedhjetë e nje) aksioneve që përfaqësojnë 1,42% të kapitalit të shoqërisë "RUBICON" SH.A. me NIPT M02129014T, me seli në Delaware (USA) me adresen qendrore 1111 New Jersey Avenue SE 524, Washington DC, 20007, USA, me vlerë 0.017742



A2024050370069627509

Dollare Amerikan çdo aksion dhe vlerë totale 55,000 Dollare Amerikan (pesedhjetë e pesë mijë).

2. Blerësi, **PRIME CAPITAL SHPK**, me NUIS **K92107012P**, me adresë në Tiranë, Km 10 Tirane-Elbasan, pranë Restorant ALPIAG Mullet, ka shprehur interes për blerjen e 3100061.0000 (tre milion e njëqindmijë e gjashtedhjetë e një) aksioneve që përfaqësojnë 1.42% të kapitalit në shoqërinë "Rubicon" SHA nga aksionet e zotëruara nga Navy Yard Capital LLC.
3. Nga kerkimi në Regjistrin e Barres Siguruese, rezulton se: Në bazë të marrëveshjes Nr.rep.496, Nr.kol 171, datë 03/02/2023, notere Belinda Celaj, vendoset: Barre Siguruese mbi të ardhurat që shoqëria Rubicon sh.a. regjistruar në Regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NIPT M02129014T, përfiton nga Banka e Pare e Investimeve-Albania sh.a., sipas Kontrates së Bashkepunimit, datë 01/02/2023 dhe anekseve të saj pasvijuese, nënshkruar midis paleve, bashkelidhur kësaj marrëveshje siguruese.

Neni 2 – Çmimi.

Shitësi, **NAVY YARD CAPITAL LLC** deklaron se ka rënë dakort me blerësin për shitjen tek ky i fundit, të 3100061.0000 (tre milion e njëqindmijë e gjashtedhjetë e një) aksioneve që përfaqësojnë 1.42% të kapitalit në shoqërinë "Rubicon" SHA me vlerë 0.017742 Dollare Amerikan për çdo aksion, në total 55,000 (pesedhjetë e pesë mijë) Dollare Amerikane, shumë e cila do të paguhet në llogarinë bankare në dollare të shitësit pranë bankës, Bank of America, llogaria nr. 004882950714, me SWIFT: BOFAUS3N.

Neni 3 - Mënyra e pageses

- Kesti i parë - 27,500 (njëzetë e shtatë mijë e pesëqind) Dollare Amerikane
Data e pageses – 30 Shtator 2024
- Kesti i dytë - 27,500 (njëzetë e shtatë mijë e pesëqind) Dollare Amerikane
Data e pageses – 7 Tetor 2024

Nëse shoqëria Prime Capital SHPK nuk kryen rregullisht pagesën sipas planit të parashikuar në paragrafin si më sipër me një vonesë më të madhe se 15 ditë për secilën pagesë, ajo humbet aksionet e blera dhe gjithashtu një penaltitet prej 10% të shumës së pageses së pakryer.

Me këtë kontratë shitje dhe pas pageses së plote të shumës 55,000 (pesedhjetë e pesë mijë) Dollare Amerikan, e bërë në dy (2) keste të barabarta, shitësi, Navy Yard Capital LLC humbet pronësinë mbi 3100061.0000 (tre milion e njëqindmijë e gjashtedhjetë e një) të aksioneve që përfaqësojnë 1.42% të kapitalit në shoqërinë "Rubicon" SHA, dhe blerësi Prime Capital Shpk me NUIS K92107012P bëhet pronar i këtyre aksioneve në shoqërinë "Rubicon" SH.A. Kjo kontratë lejohet nga palet të regjistrohet pranë QKB vetëm e shoqëruar me Mandat Pagesen bankare të vlerës së kështit të parë sipas Neni 2.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit. Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve



A2024050370069627509

nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT

PALA SHITËSE

**Navy Yard Capital LLC
Z. Eno Kotmilo**

Eno Kotmilo

PALA BLERËSE

**Prime Capital SHPK
Z. Hır Bejleri**

Hır Bejleri

**NOTER
MULI Y. MALLKUÇI**

Muli Y. Mallkuçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MULI Y. MALLKUÇI



V2024050370089254033

DATE 03/12/2024
NR REP 1584

VËRTETIM

NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 03/12/2024, para meje Noterit MULI Y. MALLKUÇI, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, VASO PASHA, NR.13/1, u paraqit personalisht:

KËRKUES:

Eno Kotmilo, atësia Gjergj, amësia Natasha, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Reshit Çollaku; Nd. 23/1; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 13/08/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036996230 dhe nr. personal I10813057F, i cili me paraqiti origjinalin e dokumentit:

- Kontrate Shitje pasuri e luajtshme (aksione), Nr.1230Rep., Nr.593Kol., date 23/09/2024, noter Muli Mallkuçi. (dokumentacioni bashkelidhur)

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MULI Y. MALLKUÇI

